Front Online

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosova**

*Qeveria–Vlada–Government*

*Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva- Ministry of Health*

Inspektorati Farmaceutik/Farmaceutski Inspektorat/Pharmaceutcial Inspectorate

| **Raport** | |
|---|---|
| **Data/Date/Datum:** | 29.05.2026 **Ref. No. 10/JV-003-26** |
| **Për/To/ Za:** | Z.Jeton Berisha, themeluess i Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatores) "Phllos pharm"(Jeton Berisha B.I), ne Ratkoc- Rahovec |
| **Përmes/Through/Preko:** | Mr. Sc Remzie Thaçi, Drejtor i Departamentit të IF-së |
| **Nga/From/Od:** | Mr.Ph. Jashar Veliu, Inspektor farmaceutik<br>Mr.Ph. Qendresa Hetemi, Inspektore farmaceutike |
| **Lënda/ Subject/Tema:** | Raport i inspektimit për Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatoren) "Phllos Pharm"(Jeton Berisha B.I) ne Ratkoc-Rahovec |
| **Cc:** | Dr Arben Vitia, Minister ne detyre i Shëndetësisë<br>Z. Jahë Gecaj, UD Sekretar i Përgjithshëm i MSh-së<br>Mr.Ph. Labinot Zeqiri, Kryeinspektor Qendror Shëndetsor<br>Mr.Ph. Arian Ahmeti, Zëvendësues i Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv në AKPPM |

## I. Përmbledhja

Inspektorati Farmaceutik me datë 28.05.2026 me qëllim të mbrojtjes së interesit/shëndetit publik ka kryer Riinspektim në Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatoren) "Phllos Pharm" në Ratkoc të Rahovecit.

Inspektimi i bazuar në Ligjin për Shëndetësi 04/L-125, Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale 04/L-190, , Udhëzimin Administrativ për Qarkulluesit me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe Ligjin 05/L-087 për Kundërvajtje të Republikës së Kosovës.

Pala është njoftuar si verbalisht ashtu edhe përmes dokumentit zyrtar se inspektimi është bërë me miratim të Inspektimit sipas ligjit per Inspektimet i cili miratim nuk është refuzuar nga personi prezent në subjektin e inspektimit.

Prezent gjatë inspektimit ishte Znj Diana Thaqi, teknike e farmacisë me numër të licencës së punës KO-51154/A-05-4.

Në fund të inspektimit u përpilua procesverbali me numër 0110308 i cili i është lexuar palës dhe është nënshkruar nga inspektorët e rastit dhe pala prezentë pa vërejtje.

## II. Metodologjia

Metodat e shfrytëzuara gjatë inspektimit:

- **Intervistimi:** Bashkëbisedimi me tekniken e farmacisë
- **Mbledhja e fakteve:** Licenca e barnatores, Çertifikata e biznesit, Licenca e farmacistit përgjegjegjës
- **Observimi:** Gjatë inspektimit janë kontrolluar dokumentacioni, hapësirat, produktet dhe pajisjet medicinale, prezenca e stafit profesional.

## III. Faktet

Inspektorati Farmaceutik me datë 28.05.2026 me qëllim të mbrojtjes së interesit/shëndetit publik ka kryer Riinspektim në Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatoren) "Phllos Pharm"(Jeton Berisha B.I) në Ratkoc të Rahovecit.
Janë kontrolluar dokumentacioni, hapësirat, produktet dhe pajisjet medicinale, prezenca e stafit profesional .
Barnatorja u gjet e hapur pa prezencën e Farmacistit përgjegjës ose zëvendësues.
Prezent ishte Znj. Diana Thaqi , teknike e farmacisë me numër të licencës së punës KO-51154/A-05-4.
Përmes procesverbalit me numër 0110308 pala është urdhëruar që të mbyllë barnatoren, të mos punojë pa prezencën e farmacistit përgjegjës ose atij zëvendësues.

## IV. Konstatimet

- Barnatorja "Phllos Pharm" me seli në Ratkoc-Rahovec posedonte licencë valide pranë AKPPM-së me numër të Licencës L5/2017/10/01347 me person përgjegjës Mr.Ph. Jeton Berisha me numër të licencës së punës KO-0300-03 njëherit edhe pronar i Barnatores se lartecekur.
- Barnatorja u gjet e hapur pa prezencën e farmacistit përgjegjës ose atij zëvendësues.
- Prezent ne Barnatore ishte Znj. Diana Thaqi, teknike e farmacisë me nr të Licences KO-51154/A-05-4.
- Në kohën e inspektimit në barnatore nuk u gjet prezent farmacisti përgjegjës ose ai zëvendësues me ç'rast konstatohet se pala ka vepruar në kundërshtim me Paragrafin 2 të Nenit 26 të Ligjit 04/L-125 për Shëndetësi, Paragrafin 2 të Nenit 14 të Ligjit Nr.04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Paragrafin 3 dhe 4 të Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr. 11/2015 për Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

## V. Rekomandimet

- Urdhërohet që në barnatore të operohet vetëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- Raportin e shoqëron Vendimi me gjobë numër 10/JV-001-26.

- Për plotësimin e rekomandimeve pala të njoftojë me shkrim Inspektoratin Farmaceutik.

Raportit i bashkangjitet :

Kopja e Procesverbalit me numër 0110308.



Front Online

Front Online

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

*Qeveria-Vlada-Government*

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Inspektorati FARMACEUTIK

0110308

(Nr. Serik)

## PROCESVERBAL I INSPEKTIMIT

28.01.2026 — (Data e fillimit të inspektimit)

12^35 — (Ora e fillimit të inspektimit)

Nr.Lic. 25/2017/FC/01344

NRB: 810735821

Në subjektin: BARNATORE "PHLLOS PHARM" RATKOC-RAHOVEC

(Emërtimi i subjektit të inspektimit)

I udhëhequr nga: JETON BERISHA – PRONAR DHE FARMACIST PËRGJEGJËS KO-0000-03

(Emri dhe mbiemri i udhëheqësit të subjektit të inspektimit)

Në adresën: RATKOC – RAHOVEC.

(Adresa e subjektit të inspektimit)

Inspektimi është realizuar nga:

MR.PH. JASHAR VELIU

MR.PH. OBNDRESA HETEMI

(Emrat dhe mbiemrat e inspektorëve dhe personave të autorizuar për inspektim)

Me numër të dokumentit të identifikimit:

MSH - 1037

MSH - 0872

(Numri përkatës i dokumentit të identifikimit të inspektorit dhe të personave të autorizuar)

Në informatat kontaktuese: jashar.veliu@rks-gov.net

(Adresa elektronike e njërit nga inspektorët dhe numri zyrtar kontaktues)

Baza ligjore e inspektimit: Ligji 08/L-067, Ligji 04/L-125, Ligji 04/L-130

Procesverbali përpilohet për: I PLANIFIKUAR – RIINSPEKTIM

(Lloji i inspektimit)

Inspektimi është bërë: me miratim [✓] pa miratim [ ]

Inspektimi është bërë pa miratim përshkak të: ...............

(Arsyeja e inspektimit pa miratim)

Pranimi i miratimit të inspektimit është refuzuar nga subjekti i inspektimit: po [ ] jo [✓]

Ka munguar personi përfaqësues i subjektit të inspektimit: po [✓] jo [ ]

Miratimi i inspektimit është vendosur fizikisht aty ku është kryer inspektimi: po [ ] jo [✓]

Arsyeja për devijimin e inspektimit nga lista e kontrollit të inspektimit është:

...............

(mbrojtja e interesit publik, shëndetit publik, sigurisë publike dhe/apo e mjedisit, nëse ka ndodhur)

Është inspektuar: DOKUMENTACIONI, HAPSIRA, TEKNIKET DHE PAJISJET MEDICINALE, PREZENCA E STAFIT PROFESIONAL

(objekti i inspektimit, si për shembull lloji i dokumentacionit, i produktit, i objektit etj.)

Me rastin e inspektimit janë marrë: ..........

(mostrat e produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve, nëse ka ndodhur)

Gjetjet e inspektimit janë: SUBJEKTI I INSPEKTUAR U GJET I HAPUR PA PREZENCEN E FARMACISTIT PERGJEGJES OSE ZEVENDESUES. PREZENT ISHTE DIANA THAQI ME NR. TE ANETARESIMIT NE OIK-5350 E CILA DEKLAROI SE ESHTE TEKNIKE E FARMACISE POR NUK KA PREZANTUAR LICENCE TE PUNES POR VETEM VERTETIMIN E ANETARESISE NE OIK, DHE EMAILIN E KONFIRMIMIT TE LICENCES SE TEKNIKUT TE FARMACISE TE DERGUAR NGA OIK KU EVIDENTOHET NR. I LICENCES KO-5354/A-05-4.

Pretendimet e subjektit të inspektimit janë: ..........

(përmbledhja nga inspektori e shpjegimit dhe pretendimit të subjektit të inspektimit, pas dëgjimit të palës)

Subjekti i inspektimit ka vërejtje si vijon: Nuk ka vrejtje

(vërejtjet eventuale të subjektit të inspektimit sa i përket gjetjeve të inspektimit)

Vendimet e marra janë si vijon: TE MBYLLET BARNATORJA DHE TE MOS OFROHET SHERBIM FARMACEUTIK PA PREZENCEN E FARMACISTIT PERGJEGJES APO ZEVENDESUES. NDESHKIM PER SHKELJET E GJETURA SIPAS DISPOZITAVE LIGJORE NE FUQI.

Inspektimi ka përfunduar më datë: 28.05.2026, në orën: 12:55

Diana Thaqi

(nënshkrimi i subjektit të inspektimit apo përfaqësuesit të tij)

(nënshkrimet e anëtarëve të trupës inspektuese)